

Rajoni i Ballkanit Perëndimor dhe konteksti gjeopolitik

Ndikimi rus

Krenar Shala
9/22/2015



Rajoni i Ballkanit Perëndimor gjendet në tërësi nën kufirin që ndan polet e mëdha gjeopolitike: Rusia në njërin anë, e cila mëton të shtrijë ndikimin e saj, dhe perëndimi në anën tjetër, e cila mëton t'i shtrijë vlerat e saj të qeverisjes së mirë përmes procesit të integritetit.

Kjo faqe lihet qëllimisht e zbrazur.

Krenar Shala

9/22/2015

Refuzimi që i bëri ish regjimi i presidentit pro-rus Janukoviç, marrëveshjes së Brukselit për lidhje më të afërta politike dhe ekonomike me Ukrainën, erdhi si pasojë e presionit të madh rus. Rusia insistonte nënshkrimin, në vend të kësaj, të Traktatit për antarësimin e Ukrainës në Bllokun Euro-Aziatik. Ky bllok është krijuar rishtazi nga Rusia në përbërje të të cilit janë disa shtete të ish BRSS-së: Bjellorussia, Kazakistani, Armenia, dhe Kirgistani.

Refuzimi i nënshkrimit të marrëveshjes me perëndimin bëri që presidenti Janukoviç të përballej me seri të mëdha demonstratash nga protestuesit e Euro Meidanit. Demonstratat kishin si qëllim të kundërtën e asaj ç'ka insistonte Rusia, pra që Ukraina të merrte kahjen tek Perëndimi. Si rezultat, regjimi i Janukoviçit u shembë. Ky revolucion klasik pastaj rezultoi me një situatë e cila prodhoi efekte gjeo-politike. Ndodhi pushtimi dhe aneksimi i Krimesë. Më pas, në emër të ruajtjes së të drejtave të qytetarëve me përkatësi etnike ruse, Rusia ndihmoi në nismën e rezistencës së armatosur të rebelëve pro-rus ndaj autoriteteve ukrainase. Ukraina, si vend gjeostrategjik dhe në "teh" të kufirit që ndan dy polet e mëdha gjeopolitike, u bë sërish fushëbetejë në mes të këtyre poleve.

Ky konflikt, i cili nga shumë analist të marrëdhënieve ndërkombëtare cilësohet si Lufta e II-të e Ftohtë, ka tensionuar edhe më shumë situatën në sistemin politik ndërkombëtar. Tani beteja është përqëndruar në secilën sferë ku polet gjeo-politike shohin interes për të fituar teren dhe shtrirë ndikimin e tyre. Njëra nga këto sfera është edhe rajoni ku jetojmë - Ballkani. Në një analizë e cila është përpiluar nga Këshilli Rus për çështje Ndërkombëtare, theksohet domosdoshmëria e shtimit të ndikimi rus përmes së ashtuquajturës "Fuqi e Butë". Raporti thekson rëndësinë që, kompanitë e mëdha ruse, gjithnjë në koordinim me institucionet e Federatës Ruse, duhet t'i japin rëndësi forcimit të ndikimit të tyre ekonomik në mënyrë që të faktorizohet Rusia politikisht dhe diplomatikisht.¹

Shtetet me të cilat synohet të arrihet ky objektivi janë Serbia, Mali i Zi, Bosna e Hercegovina, Maqedonia, si dhe Kosova, përmes veriut të saj të tensionuar. P.sh. në Mal të Zi, 1/3 e investimeve të jashtme direkte vijnë nga kompanitë ruse. Në të njejtën kohë, Serbia, si pasojë e krizës ekonomike që e ka kapluar prej fillimit të krizës ekonomike globale, ka kërkuar nga Federata Ruse kredi të buta duke shumëfishuar edhe bashkëpunimin për projekte infrastrukturore dhe energjetike. Bosna & Hercegovina gjithashtu, përkatësisht Republika Sërpska e cila është nën udhëheqjen e një lidërshipi pro-rus dhe i cili vazhdimisht kërcënon me suksesion, është një tjetër pikë e nxehtë në luftën diplomatike në mes të Rusisë dhe Perëndimit. Ndërkohë, duke e patur parasysh që shumica e shteteve të Ballkanit Perëndimor janë të varura nga gazi rus, (të rikujtojmë periudhën në mes të viteve 2006 dhe 2009, kur Rusia e ndaloi furnizimin e Ukrainës me gaz), edhe ato u përballën poashtu me probleme rreth kompenzimit të mungesës së gazit.²

Kjo manovër diplomatike bëhet në mënyrë që Federata Ruse të ketë "kartë" për të arritur synimet e veta strategjike - ç'orientimin dhe ndërlikimin e rrugës së shteteve të Ballkanit drejt integriteteve euro-atlantike. Florian Beiber nga Qendra e Studimeve për Evropën Juglindore në Universitetin e Grazit, në një portal të gjuhës serbe, theksoi: "Ne e dimë që marrëdhëniet e BE-së me Rusinë janë përkeqësuar dhe se Rusia mund të luajë një rol negativ në rajon dhe është nevoja e dërgimit të një sinjali të qartë se, me reforma dhe një bashkëpunim më të mirë rajonal këto vende mund të avancojnë rrugën e tyre drejt BE-së dhe se nuk ka alternativa të tjera". Ai më tej thekson që "Gjermania nuk e shikon me shqetësim interesimin e investitorëve rusë në rajon, por modelin autoritar rus që mund të implementohet në rajon, të cilin ne e kemi parë në Maqedoni, ku Rusia është duke mbështetur qeverinë aktuale...Jo se ata janë pro Rusisë, por duken më afër atij lloj autoritarizmi në Rusi. Prandaj, në këtë këndvështrim roli i Rusisë në rajon shihet si negativ."³

¹http://russiancouncil.ru/en/inner/?id_4=3744#top-content

²Progress and Challenges in the Western Balkans, Testimony by Ivan Vejvoda before House of Representatives, US Congress, April 2015.

³<http://www.gmfus.org/sites/default/files/IV%20-%20Hearing%20United%20States%20Congress%20House%20Subcommittee%20Europe%202029%20April%202015.pdf>

⁴<http://www.shekuilli.com.al/p.php?id=277646>

Kriza financiare shkaktoi mosbesim të theksuar të qytetarëve evropian në institucionet e entitetit. Si rrjedhojë e kësaj, qytetarët evropian gjithnjë e më shumë filluan t'a kthejnë vëmendjen tek alternativat politike të ekstremit të djathtë ose të majtë.⁴

Popullizmi në Evropë gjithnjë e më shumë po rritet. Krahës kësaj, projekti evropian gjithnjë e më shumë po rrezikohet nga menaxhimi strikt i shkurtimeve buxhetore të cilat po manifestohen në pakënaqësi popullore. Pakënaqësia po reflektohet edhe në rritjen e ksonofobisë për shkak të ardhjes së emigrantëve të paligjshëm nga rajoni i Ballkanit, duke përfshirë këtu edhe krizën e fundit të refugjatëve nga zonat e luftës në lindjen e mesme. Incidentet e kohë-pas-kohshme ndaj emigrantëve, siç ishin p.sh. rastet e vrasjeve nga ana e partisë ekstreme të djathtë "Agimi i artë", shpërfaqin tensionin që po reflektohet.⁵

Rritja e popullzimit i ka dëmtuar dhe vazhdon t'i dëmtoj masat e ndërmara fiskale të partive tradicionale politike të djathta apo të majta. Duke u përballur tashmë gjithnjë e më shumë me rritjen e madhe të partive ekstreme të djathta, të cilat insistojnë që shtetet kombëtare të kërkojnë rikthimin e sovranitetit nga Brukseli; kufizimin e ardhjes së emigrantëve të paligjshëm nga Afrika Veriore, Ballkani dhe Lindja e mesme, kryesisht, janë këto elemente të cilat kanë ndikuar edhe në rritjen e euroskepticimit. Shumë liderë evropian, duke e parë jo-popullaritetin gjithnjë e në rritje të politikës së zgjerimit, filluan t'a lëshojnë alarmin rreth domosdoshmërisë së pauzimit të këtij procesi, duke theksuar që pas hyrjes së Kroacisë më 1 korrik 2013, shtetet e tjera kandidate dhe potenciale-kandidate do të duhej të kenë parasysh që Bashkimi Evropian nuk ka mundësi absorbuese për të vazhduar procesin e zgjerimit të paktën për një periudhë 5 vjeçare.⁶

Udhëkryqi i Ballkanit Perëndimor

Duke i marrë për bazë deklaratat e liderëve evropian përfshirë këtu dhe ato të zyrtarëve të Brukselit; duke e marrë

për bazë vëmendjen e madhe që tani e sa kohë i kushtohet zgjidhjes së problemeve financiare të cilat e kanë prekur eurozonën; duke e marrë për bazë konfliktin e shpërthyer në Ukrainë, dhe duke e marrë parasysh krizën e refugjatëve, udhëkryqi në të cilën gjendet Ballkani Perëndimor është duke u ndërlikuar gjithnjë e më shumë.

Mos-gadishmëria e liderëve politik të **Bosne & Hercegovinës** për t'iu përgjigjur kërkesave të liderëve evropian për domosdoshmërinë e reformimit të sistemit institucional, në mënyrë që të jetë e mundur kapërcimi i pengesave të cilat ndërlidhen me avancimin e reformave të kërkuara për të përmbushur kriteret e Kopengahës, përbën një element mjaft të rëndësishëm të ndërlikimit të procesit.⁷

Konfigurimi institucional që u realizua si produkt i marrëveshjes së Dejtonit, megjithëse arriti të shuaj konfliktin e përgjakshëm, vazhdon të paraqes problem për funksionalitetin e shtetit; pjesërisht edhe si pasojë e mungesës së besimit të tri grupeve etnike që po e cenojnë seriozisht prespektivën evropiane të shtetit.⁸

Për të lëvizur më përpara drejt integritetit në BE, Britania e Madhe dhe Gjermania ndërmorën nismën – *qasja e re strategjike*, në nëntor të 2014, për të përshpejtuar reformat institucionale në të gjitha nivelet e shtetit, si dhe ndërmarrjen e reformave të gjera për të avancuar më tej axhendën në zbatimin e kriterëve ekonomike dhe politike të Kopengahës.⁹

Mirëpo, kjo nismë e qëlluar po hasë në pengesa politike. Të rikujtojmë thirrjen e Presidentit Milorad Dodik rreth domosdoshmërisë së mbajtjes së referendumit nga ana e Republika Sërpskas lidhur me rikonfigurimin e fuqive institucionale të prokurorëve dhe gjyqtarëve në nivel federal. Kjo thirrje hasi në kundërshtimin e ashpër të diplomatëve të BE-së, duke theksuar që ky proces nuk do të mund t'i shmang pasojat negative në kuadër të rrugës së saj drejt BE-së. Deklaratat e tyre u arsyetuan nën pretekstin që mbajtja e këtij referendum bie ndesh me marrëveshjen e Dejtonit.¹⁰

⁴<http://economistsview.typepad.com/economistsview/2009/07/what-caused-the-housing-bubble.html>

⁵<http://www.telegraph.co.uk/news/worldnews/europe/greece/9330223/Rise-of-neo-Nazi-Golden-Dawn-party-leads-to-spate-of-immigrant-attacks-in-Greece.html>

⁶<http://juncker.epp.eu/my-priorities>

⁷Nicholas Hill, Zëvendës i misionit të Ambasadës Amerikane në Bosne & Hercegovinë, intervistë për të përditshmen Oslobođenje. <http://www.oslobodjenje.ba/daily-news/hill-dodik-can-block-reform-processes-whether-hes-in-government-or-opposition>

⁸Po, aty.

⁹<https://www.gov.uk/government/speeches/bosnia-herzegovina-a-new-strategic-approach>

¹⁰<https://euobserver.com/opinion/129860>

¹¹<http://www.heritage.org/research/reports/2014/12/the-us-must-counter-russian-influence-in-the-balkans>

Lidhjet kulturore, fetare dhe historike të Serbisë me Federatën Ruse kanë qenë gjithnjë të shfrytëzuara në favor të avancimit dhe forcimit të interesave të dyanshme. E para e ka ruajtur ndikimin në rajonin tonë duke u bazuar në fuqinë diplomatike dhe ushtarake të Federatës Ruse, ndërkohë e dyta e ka përdorur Serbinë si karem për të zgjeruar ndikimin e saj në moslejimin e futjes së Ballkanit nën sferën e perëndimit si dhe për të patur qasje më të lehtë në detin Mesdhe dhe atë Adriatik.

Forcimi i këtij ndikimi është shtuar me investimet strategjike ruse në fushën e energjisë, përkatësisht në atë të gazit, e cila është përcjellur më nënshkrimin e kontratave multi-milionëshe për të shtrirë rrjetin e gazit edhe në Ballkan. P.sh. kompania shtetërore e naftës e Serbisë tanimë ka kaluar në pronësi të kompanisë shtetërore ruse, Gazprom.

Megjithatë, projekti i gaz-sjellësit South Stream, i cili është planifikuar të tejkaloj Ukrainën për t'a furnizuar Evropën përmes rajonit të Ballkanit është ndaluar Për shkak të kërkesës së BE-së në respektimin e ligjeve të saj rreth konkurrencës, të ashtu-quajturës *pakos së tretë legjislative për tregun e brendshëm të gazit dhe energjisë*.¹⁴

Rusia kalkulon poashtu, në rast të anëtarësimit, që të ruaj ndikimin e saj brenda bllokut evropian.

Forcimi i ndikimit rus është shtrirë edhe në fushën e sigurisë. Rusia ka lidhur marrëveshje me forcat e armatosura të Serbisë për bashkëpunim teknik, përkatësisht bashkëpunim në fushën e arsmimit ushtarak dhe shëndetësor. Me këtë marrëveshje synohet poashtu modernizimi i forcave të armatosura serbe përmes blerjes së pajisjeve ushtarake.¹⁵

Në vitin 2007, Kuvendi i Serbisë miratoi tekstin e Rezolutës për mbrojtjen e sovranitetit, integritetit territorial dhe rendit kushtetues, në të cilën është përfshirë edhe një pikë,¹⁶ që bën

thirrje për neutralitetin ushtarak të forcave të armatosura.

Në shtator të këtij viti, trupat ushtarake serbe iu bashkuan forcave ushtarake ruse dhe bjelloruse në një ushtrim të përbashkët, i ashtuquajtur *Vëllazëria sllave*, në territorin rus. Komisioni Europian reagoi menjëherë duke deklaruar që kjo çështje “dërgon një sinjal të gabuar”.¹⁷ Zëdhënsja e Komisionit Europian deklaroi që “Ne presim që Serbia të veprojë në përputhje me obligimet e saj në kuadër të procesit integrues”.

Kriza në Ukrainë e dëshmoi edhe një herë bashkëpunimin e ngushtë strategjik në mes të dy vendeve. Thirrjes së vendeve perëndimore për t'i vënë sanksione tregtare Moskës nuk iu përgjigj Serbia nën arsyetimin se me Federatën Ruse Serbia ka të nënshkruar një marrëveshje strategjike dhe se synon që mos t'i rëndoj këto raporte. Ndërkohë, politika e jashtme e shpallur nga lidershpi serb, mëton të ndjek interesin shtetëror duke i mbajtur dhe kultivuar marrëdhëniet vëllazërore me Rusinë, paralelisht edhe me avancimin e axhendës rreth plotësimit të kushteve të vëna nga Bashkimi Europian rreth procesit të anëtarësimit. Ndërkohë, sipas traktatit të BE-së, një shtet kandidat i cili ka filluar negociatat për anëtarësim duhet të fillojë t'a linjëzojë edhe politikën e jashtme të saj me Brukselin, si shej e vullnetit dhe seriozitetit për t'u bërë anëtar i barabart me shtetet e tjera të BE-së.

Presioni i Brukselit dhe i Washingtonit kundrejt reflektimit nga ana e Serbisë për ndryshimin e politikës së saj të jashtme është shtuar kohëve të fundit edhe me vizitën që është duke i bërë këto ditë kryeministri serb, Aleksandar Vučić Washingtonit, ftesë e cila është bërë nga e Zëvendës-Presidenti amerikan, Joseph Biden.¹⁸ Takimi pritet të karakterizohet me temën e domosdoshmërisë së Serbisë që t'i përkushtohet plotësisht të standardave të vëna nga ana BE-së dhe të sqaroj politikën e saj të jashtme.

¹⁴<http://www.bbc.com/news/world-europe-33445772>

¹⁵<http://www.spiegel.de/international/europe/germany-worried-about-russian-influence-in-the-balkans-a-1003427.html>

¹⁶http://europa.eu/rapid/press-release_MEMO-15-4829_en.htm

¹⁷<http://inserbia.info/today/2014/10/agreement-on-technical-cooperation-between-armed-forces-of-serbia-and-russia/>

¹⁸Pika 6 bën thirrje për neutralitetin e forcave ushtarake, Rezoluta për mbrojtjen e sovranitetit, integritetit territorial dhe rendit kushtetues të Republikës së Serbisë, miratuar në 26 dhjetor, 2007. (http://www.b92.net/eng/insight/strategies.php?yyyy=2007&mm=12&nav_id=46517)

Me subjektivitet dhe integritet të padefinuar nga bashkësia ndërkombëtare (OKB), Kosova është e detyruar, përkundër mendimit juridik të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, të datës 22 korrik, 2010, t'i përgjigjet kërkesës së Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së për fillimin e dialogut, me ndërmjetësimin e BE-së, rreth riaranzhimit të saj të brendshëm. Integrimi i veriut të Kosovës nën juridiksionin e Republikës së Kosovës, integrimi i suksesshëm i serbëve në jetën politike dhe institucionale, njohja nga pesë vendet e BE-së, nënshkrimi i marrëveshjes për MSA-në (ndonëse dallon nga marrëveshjet që i kanë nënshkruar shtetet e rajonit, pikërisht për shkak të refuzimit të njohjes së Kosovës nga 5 shtete të BE-së), liberalizimi i vizave, normalizimi i marrëdhënieve me Serbinë, si kusht kyq në kuadër të plotësimit të standarde të BE-së për fqinjësi të mirë, janë pengesat dhe proceset nëpër të cilat po kalon Kosova.

E hendikepuar me dobësi të theksuara në qeverisje, përcjellur me problemin e mungesës së subjektivitetit ndërkombëtar, tereni gjeo-politik mund të përbëjë shqetësim për të ardhmen e Kosovës, duke mos përjashtuar edhe mundësinë e cenimit të interesave të BE-së në raport me procesin e integritetit të vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Duke e patur parasysh dhe ndikimin rus në rajon, nuk është e habitshme që Rusia do t'a përdorë asociacionin si levë për të rritur pazarin në kontekstin gjeo-politik të rajonit tonë.¹⁹

Njejtë, shëndërrimi i FSK-së në ushtri do të përcillet me kundërshti nga ana e Beogradit, ku nuk përjashtohet mundësia që edhe ushtria e ardhshme e Kosovës të jetë e organizuar në dy garnizone: një për territorin e Republikës së Kosovës dhe tjetra për territorin e Bashkësisë së Komunave Serbe. Efektet politike të kësaj formule do të kenë efekt edhe në kuadër të procesit të ardhshëm të anëtarësimit të Kosovës në NATO. Sipas të gjitha gjasave, Kosova do të detyrohet, përmes një resolute në Kuvend, t'i shpallë forcat e veta të armatosura si forca neutrale, pra të ndalojë anëtarësimin e Kosovës

në ndonjë organizatë ushtarake multilaterale, siç mund të jetë aleanca veri-atlantike, NATO. Të kujtojmë, që një ditë pas anëtarësimit të Kroacisë dhe Shqipërisë në NATO, Institucionet e Serbisë riafirmuan qëndrimin e tyre lidhur me neutralitetin e forcave të armatosura, e cila arsyeton mosgadishmërinë e saj për t'i u bashkuar ndonjë mekanizmi supranacional të sigurisë.

Sipas të gjitha gjasave, Kosova do të detyrohet, përmes një resolute në Kuvend, t'i shpallë forcat e veta të armatosura neutrale karshi anëtarësimit në ndonjë organizëm multilateral të sigurisë, duke përfshirë Aleancën Veri-atlantike (NATO).

Se Federata Ruse do t'i përdorë të gjitha mjetet në dispozicion për të mos lejuar zgjerimin e kufijëve të NATO-s, tregon edhe rasti i fundit, në qershor të këtij viti, kur Ambasadori rus në Suedi, Viktor Tatarintsev, kërcënoi me ndërmarrjen e masave nëse Suedia dhe Finlanda i vazhdojnë përpjekjet e tyre për anëtarësim në aleancën ushtarake perëndimore. Ai më tej tërhoqi vërejtjen duke thënë se "Presidenti Putin ka sinjalizuar që do të ketë pasoja dhe që Rusia do t'a konsideroj intervenimin ushtarak si dhe do të bëjë riorientimin e trupave ushtarake dhe raketave balistike". "Një shtet i cili vendosë t'i bashkohet NATO-s, duhet të jetë i vëmendshëm rreth rreziqeve që mund t'iu ekspozohet."²⁰

Të rikujtojmë poashtu vendimin e Këshillit European për zbatimin e sanksioneve ekonomike dhe tragtare ndaj Federatës Ruse si pasojë e krizës në Ukrainë, përkatësisht aneksimit të Krimesë. Bashkimi evropian, siç është e përcaktuar edhe me kriteret e Kopenhagës, iu bëri thirrje vendeve kandidate (Shqipërisë, Malit të Zi, Serbisë, Turqisë) dhe potenciale kandidate (Kosovës dhe Bosnjë e Hercegovinës), që të renditen pas vendimit të saj për vendosjen e sanksioneve kundër

¹⁹<http://www.balkaninsight.com/en/article/eu-opposes-to-serbia-s-military-drills-with-russia-08-18-2015-1>

¹⁹<http://live.kallxo.com/sq/MTL/Anetaret-e-Kongresit-Amerikan-Ngrene-Shqetesime-per-Kryeministrin-Serb-8260>

¹⁹Intervistë me analistin e marrëdhënieve ndërkombëtare, Naim Rashiti.

Federatës Ruse. Kosova iu përgjigj kësaj thirrjeje, përkundër nivelit të ulët të raporteve tregtare.

Qëllimi strategjik rus, ndër tjerash, është edhe sabotimi/ndërlikimi/bllokimi/parandalimi i vendeve tjera drejtë anëtarësimit në NATO. Pra, krjimi i Bashkësisë së Komunave Serbe, sipas të gjitha gjasave, përpos Serbisë, do t'i hyj në punë edhe Rusisë në arritjen e objektivit të saj strategjik.

Maqedonia dhe Marrëveshja e Ohrit

Freedom House e përshkruan Maqedoninë si shtet me qeverisje tranzicionale apo regjim hibrid. Raporti më tej, vë në pah historikun e zgjedhjeve parlamentare dhe atyre presidenciale, të cilat ishin karakterizuar me mbulim të anshëm nga mediat proqeveritare si dhe abuzim të burimeve administrative, gjë e cila solli një bojkot të gjatë nga forcat politike opozitare.²¹

Afera me përgjimet të cilat i lansoi në publik opozita, përkatësisht partia më e madhe maqedonase LSDM, e kryesuar nga lideri i saj, Zoran Zaev, tronditi më tej themelet e demokracisë dhe institucioneve. Mekanizmat diplomatik të Brukselit dhe Washingtonit u vunë nën shqyrtim duke u mundur që të ndërmjetësojnë arritjen e një marrëveshjeje në mes të pushtetit dhe opozitës në mënyrë që të gjendet një zgjidhje rreth stabilitetit demokratik të institucioneve. Pas një procesi maratonik të negociatave, u arrit një marrëveshje politike për stabilizimin e situatës politike.²²

Në anën tjetër, nuk mugo i diplomacia ruse e cila u vu në anën e pushtetit, duke arsyetuar veprimin e saj nën pretekstin që Perëndimi, me qëllim, është duke shfrytëzuar partitë opozitare, veçanërisht ato shqiptare, për të rrëzuar pushtetin si reagim ndaj mos-gadishmërisë së Qeverisë Gruevski për vënien e sanksioneve ndaj Federatës Ruse.²³

Pra qëllimi i këtyre ndërhyrjeve diplomatike ruse është zbatimi në praktikë i zgjerimit të ndikimit gjeo-politik rus në rajon duke u bërë palë negociuese. Ky pozicion do t'i mundësonte

arritjen e synimit të saj në shpërqëndrimin e shteteve të rajonit drejt realizimit të objektivave të tyre për reformim të sistemit shtetëror dhe demokratizimit institucional e shoqëror.

Ndërkohë, duke e patur parasysh fenomenin e korrupsionit prej të cilit vuan në masë të madhe i tërë rajoni, duke mos përjashtuar këtu edhe partitë politike shqiptare, përpjekjet për arritjen e objektivit për të shtyrë përpara realizimin e zbatimit, në plotëni, të marrëveshjes së Ohrit, janë shumë të qullta.

Kjo po ngjallë mjaft tensione në skenën politike duke pamundësuar që shqiptarët dhe maqedonasit, duke përfshirë dhe grupet e tjera etnike, të përqëndrohen tek vëmendja që duhet t'i ipet zhvillimit të barabart ekonomik, demokratizimit institucional e shoqëror si dhe sundimit të rendit dhe të ligjit.

Kjo situatë është duke i kontribuar atmosferës tensionuese e cila është e volitshme për rritjen e ndikimit rus.

Shqipëria – pengesë e Greqisë

Në qershor të vitit të kaluar, Shqipëria zyrtarisht mori statusin e vendit kandidat për anëtarësim në Bashkimin Europian. Për të bërë të mundur hapjen e negociatave për anëtarësim, Komisioni Europian i ka kërkuar Shqipërisë që të fokusohet në përmbushjen e 5 kriterëve: krijimin e një administrate profesionale dhe të depolitizuar; forcimin e pavarësisë së institucioneve të drejtësisë; luftën kundër korrupsionit; luftën kundër krimit të organizuar, dhe; mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të njeriut.²⁵

Përpos këtyre kriterëve, shteti fqinj – Greqia, ka paralajmëruar që rruga e Shqipërisë drejt Brukselit varet edhe nga suksesi i Shqipërisë në tejkalimin e pengesave si: demarkimi i kufirit detar – proces i cili ka mbetur pezull si pasojë e vendimit negativ të Gjykatës Kushtetuese; çështja e toponimeve, si dhe shfuqizimi i ligjit të luftës, i cili ende është në fuqi, përkundër anëtarësimit të Shqipërisë në NATO.²⁶

Në vizitën e fundit që i bëri Shqipërisë, ministri i jashtëm grek, bëri të qartë që rruga e Shqipërisë

²⁰https://foreignpolicy.com/2015/09/01/swedes-lean-toward-nato-await-moscow/?utm_content=buffer63b7&utm_medium=social&utm_source=facebook.com&utm_campaign=buffer

²¹<https://freedomhouse.org/report/nations-transit-2015/democracy-defensive-europe-and-eurasia#Veb08SWqqko>

²²http://ec.europa.eu/commission/2014-2019/hahn/announcements/agreement-skopje-overcome-political-crisis_en

²³<http://www.novinote.com/articles/168689/Russia+Claims+Macedonia+Crisis+Managed+from+Abroad>

²⁴<http://carnegieeurope.eu/strategieurope/?fa=57301>

drejt BE-së nuk do të jetë e lehtë nëse Shqipëria nuk tejkalon problemet e mbetura me fqinjin jugor.²⁷

Ndikimi rus mund të vihet në pah edhe këtu. Gjatë negociatave për borxhin, pas ardhjes në pushtet të Syriza, qeveria e re deklaroi që marrëveshjet e arritura nga qeveritë paraardhëse duhet të rinegociohen sepse janë të dëmshme për ardhmërinë ekonomike të vendit. Ngurrimi për t'i marrë parasysh kërkesat e Greqisë nga ana e Brukselit shkaktoi tension i cili vuri në lëvizje diplomacinë greke për të kërkuar ndihmë edhe tek shtetet tjera, si Rusia. Gjatë takimit me Presidentin Rus, Vladimir Putin, ky i fundit deklaroi që Rusia është e gatshme t'i ndihmoj Greqisë me kredi të buta në mënyrë që të ndihmojë në stabilizimin financiar të shtetit Helen.²⁸

Pra, intenca e rritjes së ndikimit rus në rajon u shfaq edhe në Greqi, përkundër mos-arritjes së mirëkuptimit nga ana e Greqisë pas arritjes së marrëveshjes me kreditorët për të riarranzhuar marrëveshjen për huadhënie. Ndërkohë, Federata ruse është duke u munduar që përmes Greqisë të mund të arrij ç'rregullojë rrugën e vendeve të Ballkanit Perëndimor drejt aleancës euro-atlantike.

Ndërkohë, Federate Ruse publikoi listën e vënies së sanksioneve ndaj shteteve të cilat janë pajtuar që t'i vendosin sanksione Rusesë. Në këtë listë u gjend edhe Shqipëria.²⁹

Ndikimi rus ka filluar të vërehet edhe në sferën kulturor-sociale. Ambasada ruse në Tiranë njoftoi opinionin publik, në shtator të këtij viti, rreth nismës së saj për të ofruar kurse të gjuhës ruse target e të cilat mund të jenë studentët e interesuar.³⁰ Të rikujtojmë hapat që tashmë ka ndërmarr Federata Ruse në drejtim të prezantimit të literaturës së saj në vendet e tjera perëndimore në mënyrë që të ngrisë reputacionin e saj. P.sh. në fund të qershorit të këtij viti, u organizua festivali i Librave rus në të cilën u prezentuan së paku 100 volume të literaturës ruse në gjuhën angleze.³¹

Megjithë përparimin e dukshëm drejt përmbushjes së kriterëve për anëtarësim dhe përkundër dakordimit nga ana e diplomacisë malazeze rreth vendosjes së sanksioneve ndaj Federatës Ruse, roli i kësaj të fundit nuk mund të injorohet lehtë. Zgjerimi i tregjeve gërsheton në vetëvete dhe mundësinë e ndërhyrjes së një shteti të caktuar, për të mbrojtur apo avancuar të drejtat e investitorëve prej nga e kanë origjinën. Kjo vlenë sidomos për shtetet me institucione politike dhe ekonomike përjashtuese, siç është Rusia. Ekonomia ruse ende vuan nga sistemi oligarkik i formësuar pas rënies së murit të Berlinit, përkatësisht ndryshimeve demokratike atje. Ky sistem oligarkik mundëson krijimin e një marrëdhënieje klienteliste në mes të lidershipit politik dhe biznesmenëve të ndryshëm. Shtetet e tilla tentojnë që të përdorin bizneset edhe për arritjen e objektivave diplomatike përmes investimeve të jashtme.

Sidoqoftë, edhe pse investimet e jashtme direkte të kompanive ruse përbëjnë rast për të rritur ndikimin rus në rajon, BE-ja si entitet më atraktiv ekonomik e ruan ndikimin e saj të madh në sferën politike dhe ekonomike të Malit të Zi. Përgjigjja afirmative ndaj kërkesës së BE-së për t'i vendosur sanksione Federatës Ruse nga ana e Malit të Zi, dëshmon që BE ruan ndikimin substancial në zhvillimet politike dhe ekonomike të saj.

Megjithatë, duhet të rikujtojmë vendimin e Këshillit Veri-atlantik për mundësinë e dhënies së ftesës Malit të Zi. Sekretari i NATO-s, Stoltenberg, në takimin e fundit që pati me kryeministrin malazes, Gjukanoviç, theksoi se ministrat e jashtëm të shteteve anëtare të NATO-s do t'a vlerësojnë, në fund të këtij viti, përparimin e shtetit malazes drejt përmbushjes së kriterëve për anëtarësim.³² Pra nuk përjashtohet mundësia që nga viti i ardhshëm, NATO-s do t'i bashkohet edhe një anëtar i ri.

²⁷<http://www.integrimi.gov.al/al/newsroom/deklarata-per-shtyp/pese-prioritetet-per-statusin-ja-masat-konkrete-te-qeverise&page=1>

²⁸<http://www.shekulli.com.al/p.php?id=286345>

²⁹Po, aty.

²⁸<http://russia-insider.com/en/putin-offers-cooperation-greece-no-financial-aid/5434>

²⁹<http://www.euronews.com/2015/08/13/russia-expands-its-food-ban-to-another-four-countries-and-gives-ukraine-extra/>

³⁰<http://klankosova.tv/putini-rrit-ndikimin-ne-shqiperi-hap-kurse-te-rusishtes/>

³¹http://foreignpolicy.com/2015/08/31/the-rise-of-bulgakov-diplomacy-russian-literature-vladimir-putin-read-russia/?utm_content=bufferdd9d4&utm_medium=social&utm_source=facebook.com&utm_campaign=buffer

Federata Ruse, si fuqi rajonale, pas shembjes së murit të Berlinit, përjetoi një rënie drastike të reputacionit të saj diplomatik, ekonomik dhe politik. Siç do të thoshte Presidenti Vladimir Putin, “Shkatërrimi i Bashkimit Sovietik ishte tragjedia më e madhe gjeo-politike e shekullit XX-të”.³³

Kjo fjali shihet nga shumë analistë të marrëdhënies ndërkombëtare si thirrje e qytetarëve rus për të ringritur shtetin në pedestalin që e gëzonte në shekullin e kaluar. Shembujt si krijimi i unionit Euro-Azi me disa nga ish vendet që e përbënin atëbotë Bashkimin Sovjetik, aneksimi i Krimesë si kundërpërgjigje ndaj planeve të perëndimit për të integruar Ukrainën në gjirin e saj, rezistenca e diplomacisë ruse ndaj thirrjeve të perëndimit për të larguar nga pushteti Presidentin Asad, diversifikimi i eksportit të gazit natyror (marrëveshja biletarale me Kinën), si dhe tentimi për të ndërhyrë diplomatikisht në rajonin e Ballkanit - pak përmes pranisë relativisht të madhe të investimeve të huaja direkte që kanë origjinë nga Rusia dhe pak nga historia e lidhjeve tradicionale të popujve ortodoks me të, ka bërë që të ngritet alarmi për Brukselin dhe Washingtonin. Shtimi i përpjekjeve diplomatike në rrafshin e investimeve në infrastrukturë dhe energjetikë siç ishte rasti i fundit i Samitit të Vjenës, pasardhëse e Samitit të Berlinit, janë një ndër mënyrat për të bërë të mundur përsheptimin e hyrjes së vendeve të Ballkanit Perëndimor në BE.³⁴ Samiti i rradhës pritet në mbahet në Paris, në gusht të vitit të ardhshëm. Kjo është nisma më serioze qysh prej Samitit të Selanikut, më 2003, në të cilën edhe zyrtarisht, vendet e BE-së i dhanë prespektivë të anëtarësimit vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Në një fjalim të mbajtur në Kroaci, Asistentja e Sekretares, Byroja për çështje të Evropës dhe Euro-azisë, Victoria Nuland, tha se liderët e ballkanit dhe qytetarët e saj duhet t'i përqendrojnë përpjekjet e tyre në 3 gjëra:

“E para, përfundimi i ndërtimit të procesit demokratik për të bërë të mundur që më në fund t'i ipet fund urrejtjeve dhe rivaliteteve të vjetra;”

“Së dyti, të filloj prosperiteti dhe rritja duke bërë të mundur ndërlidhjen e të gjitha shteteve të rajonit me rrugë të reja, linja hekurudhore të reja, porte dhe infrastrukturë të re.”

“Së treti, të bëhet bashkimi i forcave për të bërë Ballkanin zonë të ndaluar për kërcënimet më djallëzore ndaj shtetësisë dhe lirisë individuale: ekstremizmit të dhunshëm, korrupsionit dhe kriminalitetit, si dhe për autokratët dhe oligarkët të cilët mbajnë dhurata që e promovojnë interesit e tyre, jo të juajin.”³⁵

³³<http://www.politifact.com/punditfact/statements/2014/mar/06/john-bolton/did-vladimir-putin-call-breakup-ussr-greatest-geop/>

³⁴<http://www.bmeia.gv.at/en/european-foreign-policy/foreign-policy/western-balkans-summit-vienna-2015/>

³⁵<http://www.state.gov/p/eur/rls/rm/2015/jul/244800.htm>

Rekomandimet

- Institucionet financiare të BE-së duhet të gjejnë mënyra financimi të projekteve energjetike dhe infrastrukturore në mënyrë që vendet e Ballkanit Perëndimor të kenë një shtytje më domethënëse në përparimin ekonomik përmes bashkëdyzimit të interesave të tyre. Kjo ndikon që të koordinohet më mirë procesi i përmbushjes së standardeve për anëtarësim në BE;
- Duke e konsideruar burimin natyror – gazin si njëra ndër burimet më efikase që ka në dispozicion Federata Ruse për të shtrirë ndikimin e saj në rajon, duhet të shtohet asistenca financiare për të bërë të mundur realizimin e projektit TAP që përshkon nga Azerbejxhani në drejtim të Italisë, pra, ndërlidhjen me sistemin përçues të gazit për në Kosovë, Mal të Zi, Serbi dhe Bosne e Hercegovinë;
- Të shtohen fondet lidhur me financimin e projekteve ndaj OJQ-ve të Ballkanit Perëndimor për të bërë të mundur shtimin e aktiviteteve që kanë synim avancimin e parimeve të qeverisjes së mirë, rritjen e transparencës dhe llogaridhënies, forcimin e mekanizmave institucional të sistemit të drejtësisë, si dhe konsolidimin e mëtutjeshëm të demokracisë institucionale dhe shoqërore, në veqanti mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të grupeve të marginalizuara dhe minoriteteve etnike;
- Të shtohet presioni diplomatik përmes shfrytëzimit të politikave *shkop-karrotë* lidhur me mos-ndërhyrjen në punët e brendshme të Serbisë karshi Kosovës përmes Asociacionit të nënshkruar rrishtazi; Bosne & Hercegovinës për të deleguar më shumë kompetenca tek niveli federal duke e bërë të mundur ndryshimin e kushtetutës e cila do të ishte e pranueshme për vendet anëtare të BE-së; si dhe Maqedonisë e cila duhet të shtojë përpjekjet për zbatimin në plotëni të Marrëveshjes së Ohrit si dhe të kontribuoj uljes së tensioneve ndëretnike të cilat mund t'i kushtojnë politikisht dhe në aspektin e sigurisë ardhmërisë së Maqedonisë në rrugën e saj drejt BE-së;
- Krahas shtytjes për të zbatuar pakon e re financiare të dakorduar në mes të BE-së dhe Greqisë, BE duhet të përqëndrohet edhe tek shtytja e të dy vendeve që të arrijnë një kompromis për emrin e Maqedonisë si dhe të merret vendimi për njohjen e Kosovës;
- Njohja e pavarësisë dhe subjektivitetit ndërkombëtar nga 5 vendet e BE-së duhet të jetë njëra ndër objektivat qendrore të vendeve më të fuqishme të BE-së;
- Zhvillimi ekonomik, sundimi i ligjit dhe demokratizimi i mëtutjeshëm institucional e shoqëror duhen të jenë në fokusin qendror të politikës së jashtme të BE-së. Kjo është mënyra më efikase për të siguruar stabilitet afat-gjatë për vendet e Ballkanit Perëndimor.

²⁹<http://www.integrimi.gov.al/al/newsroom/deklarata-per-shtyp/pese-rrioritetet-per-statusin-ja-masat-konkrete-te-qeverise&page=1>

²⁶<http://www.shekulli.com.al/p.php?id=286345>

²⁷Po, aty.

²⁸<http://russia-insider.com/en/putin-offers-cooperation-greece-no-financial-aid/5434>

²⁹<http://www.euronews.com/2015/08/13/russia-expands-its-food-ban-to-another-four-countries-and-gives-ukraine-extra/>

³⁰<http://klankosova.tv/putini-rrit-ndikimin-ne-shqiperi-hap-kurse-te-rusishtes/>

³¹http://foreignpolicy.com/2015/08/31/the-rise-of-bulgakov-diplomacy-russian-literature-vladimir-putin-read-russia/?utm_content=bufferdd9d4&utm_medium=social&utm_source=facebook.com&utm_campaign=buffer



Pashko Vasa 7
Prishtina, 10.000
Republic of Kosovo
+381 38 609 900
contact@fes-prishtina.org
www.fes-prishtina.org

E drejta autoriale © 2015 e FES-it. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk guxon të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të ruajtjes së të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë elektronike, mekanike, fotokopjuese, incizuese apo tjetër, pa pëlqimin paraprak me shkrim nga ana e botuesit.

Përmbajtja dhe qëndrimet e shprehura në këtë analizë janë të autorit dhe nuk duhet të konsiderohen domosdoshmërisht si qëndrime të FES Prishtina.